

DPK/DMP

03-350/2013

02

12.02.2013

Nr. 490-05 /12

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE**, me gjykatesen Vjollca Buzhala e me procesmbajtesen Melihate Shaipi ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit Besnik Krasniqi nga Prizreni , per shkak te kundevajtjes nga neni 5 , 6, par.1 .3 dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/ L- 050, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , dhe deklarimin , prejardhjen , dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sakncionuar ne baze te nenit 17 par. 1 . 3 te Ligjit te lart cekur , e ne kuptim te nenit 195 te LMK-se me dt. 25.01.2013 mori kete

#### A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundervajtese ndaj te pandehurit Besnik Krasniqi nga Prizreni , si zyrtar I larte publik – asambleist ne ansamblene komunal (professor ne shkollen special Nena Terez ) ne Prizren , per shkak te kundevajtjes nga neni 5 , 6, par.1 .3 dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/ L- 050, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , dhe deklarimin , prejardhjen , dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sakncionuar ne baze te nenit 17 par. 1 . 3 te Ligjit te lart cekur .

-konform nenit 198 al.1 p.8 te Ligjit mbi kundervajtjet, pasiqe nuk ka prova qe e pandehura ka kryer kundervajtjen.

Shpenzimet e procedures kundervajtese biejne ne bare te mjeteve buxhetore te kesaj gjykate.

#### A r s y e t I m

Sipas kerkeses se Agjensionit antikorupcion ne Prishtine, me nr. 01- 1905/2012 te dt. 24.05.2012 eshte ngritur procedura kundervajtese kunder te pandehurit Besnik Krasniqi nga Prirzeni- asambleist ne ansamblen Komunale ne Prizren per shkak te kundervajtjes nga neni I lartecekur ne dispozitiv te aktvendimit.

Gjyqtari filloi proceduren kundervjatese ne Gjykate ne seancen verbale te dt. 19.12.2012 ku i cili pos tjerash theksoi :

Eshte e vertet se me date 24.05.2012. eshte ngritur procedura kundervajtese ndaj meje si zyrtar publik ne cilesine e asambleistit Komunale ne Prizren per shkak te mosdeklarimit te pasurise . Une kete formulare e kame marrur keshteu qe e kame plotsuar dhe me kohe ia kame dorzuar zotit Ibrahim Krasniqi dhe nuk kame ditur se I njeiti nuk e ka dorzuar ne agjencionin kunder korrupcionit , per te cilen gje ua sjellur formularin si prove material I prerzentuar me kohe .

Andaj Gjykata me qellim te vertetimit te drejte te gjendjes faktike ne cilesi te deshmitarit mori ne pyetje zyrtarin e larte – te mbikqyrjes se pasurise ne AKK Enis Sadiku I cili pos tjerash theksoj: Eshte e vertete se Agjensioni antikorupcion permes pikave konstaktuese ka njoftuar zyrtaret e larte per obligimin e deklarimit te gjendjes se pasurise dhe nje nder ata persona është edhe zyrtari Besnik Krasniqi - asambleist ne Asamblen Komunale ne Prizren . Agjensioni antikorupcion ka bere njoftimin per kete zyrtar se afati I fundit ligjro per deklarimin e pasurise

eshte data 31.03.2012 dhe qe nga data e marjes se njoftimit dhe me dt. e parashikimit te nje personi ne fjale nje gje te tille nuk e ka bërë ,kjo mund te konstatohet se zyrtari I larte ka qene I njoftuar ne baze te listes distribuese qe është shperndare me dt. 01.03.2012 e të cilën e ka pranuar edhe i njëjti.

Gjithashtu gjykata per ta vertetuar gjendjen faktike ftoi ne cilsu te deshmitarit Samir Hoxhen - ish shef I protokolit ne kabinetin e kryetarit te komunes ne Prizren si pike kontaktuese I cili ne deklaraten e tij te thene ne gjykate me date 8.11.2012. theksoi : une personalishte lidhur per formularin per deklarimin , preardhjen dhe kontgrollin e pasurise e kame njoftuar personin kompetent zortin Ibrahim Gashi e besoi qe I njejt i ka njoftuar me kohe

Deshmitari Ibrahim Krasniqi si shefi I sherbimit profesional ne deklaraten e dhene ne gjykate me date 12.12.2012. theksoi : une ne cilsine e kordinatorit per sherbime profesionale deklaroi se asne formulare nuk kame pranuar personalishte nga zorti Samir Hoxha si pike kont aktuese sepse na ka njoftuar vetem gojarishte keshteu qe une iu kame shpendare antareve te Kuvendit formularet te cilet une I kame poseduar keshteu qe I njeji me kohe e ka dorzuar tek une me date 3.08.2012. ( formularin e vjeter ) , keshteu qe une nuk kam patur dijeni se duhet ti dergoi ne agjencionin antikorruption , nga se edhe herave tjera I kane plotsuar formularet por kane ngelur tek une dhe nuk ka patur asnje problem .


Gjendja faktike e pershkruar me persëafirmi si ne dispozitiv të ketij aktvendimi është vertetuar permes deklarates se te pandehurit , deklarates se zyrtarit te larte per antikorruption , pikes kontaktuese - zyrtarit Samir Hoxha , deshmitarit Ibrahim Krasniqi - shef I sherbimit profesional , listes distributive te dt. 01.03.2012. si dhe me administrimin e provave tjera ne shkresat e lendes .

Nga arsyerat e cekura me larte gjykatesi nuk gjet prova se I pandehuri ka kryer kundervajtjen e cila I bie ne bare ne baze te kerkeses se Agjensionit antikorruption ne Prishtine, me nr. 01- 1908/2012 te dt. 24.05.2012 me te cilin, eshte ngritur procedura kundervajtese kunder te pandehurit Besnik Krasniqi nga Prirzeni- assembleist ne ansamblen Komunale ne Prizren per shkak te kundervajtjes nga neni I lartecekur ne dispozitiv te aktvendimit andaj, konform nenit 198 al.1 p.8 te Ligjit mbi kundervajtjet ka pezulluar procedure Kundervajtse.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, DIVIZIONI PER KUNDERVAJTE ,  
Nr. 490/05-2012 dt. 25-01.2013.

Procesmbajtsia  
Melihate Shaipi



Gjykatesi per kundervajtje  
Vjollca Buzhala

UDHEZIMI JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi e ne afat prej 8 ditesh nga dorezimi mund te ushtrohet ankese Gjykates se Apelit ne Prishtine Divizioni per kundervajtje , Ankesa dergohet nepermjet te kesaj gjykate pa taksa.